REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
|SHKOLLA E MESME PROFESIONALE
HOTELERI - TURIZEM"

PLAN PUNE PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM

SHKOLLA E MESME PROFESIONALE "HOTELERI – TURIZËM"

2025 - 2026

Qëllimi: Të rritet ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit dhe të realizohen praktika të qëndrueshme në procesin mësimor, në kuzhinë , bar, laboratorë dhe hapësira të tjera të shkollës, duke ulur ndotjen dhe konsumin e burimeve natyrore

Objektivat:

Të reduktohet mbetjet ushqimmore dhe plastika një përdorimshe.

Të promovohet riciklimi dhe ripërdorimi i materialeve.

Të kursehet energjia elektrike dhe uji.

Të përdoren produkte miqësore me mjedisin për pastrimin e ambienteve.

Të zhvillohen aktivitete edukative me nxënësit për mjedisin e qëndrueshëm.

Nr.	Fusha e veprimit / Aktiviteti	Përshkrimi	Përgjegjës	Afati i zbatimit
1	Shfrytëzimi i mbetjeve të gjelbra (perime e fruta)	Përdorimi i pjesëve të mbetura për përgatitjen e bulionit dhe lëngjeve aromatike për të shfrytëzuar produktin 100%.	Mësuesit e praktikës dhe nxënësit e kuzhinës	Gjatë gjithë vitit
2	Riciklimi i vajit të përdorur	Grumbullimi i vajit për riciklim në biokarburant (biodiesel) ose sapunë ekologjikë.	Mësuesit e praktikës	Çdo muaj
3	Menaxhimi i furnizimeve	Blerja e produkteve bëhet një herë në javë për të shmangur paketimet dhe mbetjet ushqimore.	Magazineri dhe përgjegjësi i bazës prodhuese	Gjatë gjithë vitit
4	Kursimi i energjisë elektrike	Shkëputja nga rrjeti e pajisjeve gjatë kohës që nuk përdoren (përveç frigoriferëve).	Mësuesit e praktikave	Çdo ditë

			dhe stafi teknik	
5	Kursimi dhe ripërdorimi i ujit	Përdorimi racional i ujit në kuzhinë, bar, lavanderi dhe ripërdorimi i tij për pastrime.	Mësuesit e praktikave, punonjësit e mirëmbajtjes	Çdo ditë
6	Ripërdorimi i materialeve dhe ambalazheve	Ripërdorimi i shisheve dhe ambalazheve të qelqta, shmangia e produkteve njëpërdorimshme	Mësuesit e praktikave, nxënësit	Gjatë gjithë vitit
7	Klasifikimi i mbetjeve	Klasifikimi i mbetjeve sipas materialeve në koshat pë rkatë s(plastikë ,letë r, metal)	Mësuesit e praktikave, nxënësit punonjësit e mirëmbajtjes	Gjatë gjithë vitit
8	Përdorimi i produkteve ekologjike	Zëvendësimi i pastruesve kimikë me produkte natyrale si uthulla dhe lëngu i limonit kur është e mundur	Mësuesi i lavanterisë, nxënesit, punonjësit e mirëmbajtjes	Gjatë gjithë vitit
9	Përdorimi me kapacitete të plota	Përdorimi me kapacitete të plota në lavanderi dhe zbatimi i temperaturave të duhura gjatë larjes	Mësuesi i lavanderisë nxënësit punonjësit e mirëmbajtjes	Gjatë gjithë vitit
10	Ripërdorimi i ujit	Pas larjes, tharjes së rrobave ripë rdorimi i ujit për larjen e dyshemesë dhe furnizimit të hekurit të hekurosjes	Mësuesi i lavanterisë nxënësit punonjësit e mirëmbajtjes	Gjatë gjithë vitit
11	Përgatitja e porcioneve	Pë rgatitja e porcionevetë vogla në Shërbimin e ushqimeve në restorant (shmangia e paketimeve)	Mësuesit e restorantit, nxënësit	Gjatë gjithë vitit
12	Përdorimi i akullit të mbetur	Akulli i mbetur përdoret për ujitjen e luleve ose larje të mjeteve.	Mësuesit e barit dhe laboratorëve	Çdo ditë

13	Aktivitet ndërgjegjësues	Edukimi për kujdes ndaj mjedisit përmes aktiviteteve në Ditën e Ujit dhe Ditën e Tokës	Mësuesi i Mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm klubi i mjedisit	22 Mars, 22Prill
14	Pasurimi i kopshtit të shkollës	Përkujdesja ndaj bimë vetë kultivuara në shkollë	Klubi i mjedisit	Gjatë gjithë vitit

Grupi i punës:

- Rajdi Pojanaku
- Esmeralda Meta
- Ëngjëllushe Nezha
- Laura Talo
- Albana Pelivani
- Arbër Hala

Drejtor

Elona Qehajaj